



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

Procesverbal për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës së prokurimit në lote me objekt Mirëmbajtja dhe Menaxhimi i Sheshit “Skënderbej”

I mbajtur sot në datë 07.04.2023 nga anëtarët e Njesisë së Prokurimit, për përcaktimin e arsyeve për mosndarjen e procedurës në lote, përkatësisht për procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtja dhe Menaxhimi i Sheshit “Skënderbej”, me fondi limit 119.112.119,24 (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e njëqind e dymbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëmbëdhjetë presje njëzet e katër) lekë pa TVSH.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote **sa herë kjo është e mundur**. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Në zbatim të nenit të sipërpërmendur, Njësia e Prokurimit gjykon se kjo kontratë nuk mund të ndahet në lote për arsyet e mëposhtme:

1. Kjo procedure shërbimi duhet të kryhet nga një operator ekonomik, pasi lloji i shërbimit për të qene sa më efikas duhet të jete i përqendruar tek një operator ekonomik . Eshhtë më e përshtatshme duke patur parasysh natyrën e shërbimeve të parashikuara, specifikimeve teknike dhe termave të referencës të vendosura në kërkesat e Autoritetit Kontraktor, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, nga ana teknike dhe organizative. Gjithashtu nisur nga kompleksiteti i shërbimeve, të cilët duhet të ndiqen në vazhdimësi dhe në kohë reale është e nevojshme që shërbimet të kryhen nga një operator ekonomik dhe specialistët e tij.
2. Kryerja nga një operator ekonomik e ben me efektiv organizmin e punes por sidomos e ben shume me te pershtatshem monitorimin dhe raportimin e te gjitha proceseve te punes qe ky shërbim ka. Ndarja ne lote do te sillte konfuzion dhe crregullim ne proces dhe veshtiresi ne monitorim te shërbimit si dhe kosto shtese per AK.

Si përfundim, për shkak të arsyeve teknike dhe organizative të përmendura më lart, kjo procedurë për vetë rendësinë dhe specifikat e veçanta që ka realizimi i këtij shërbimi, gjykojmë se realizimi i procedurës në një kontratë të pa ndarë në lote është një veprim i drejtë,në

përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, që do të shoqërohej me mirëorganizimin e operatorit për realizimin e shërbimit në kohë sipas kërkesave dhe nevojave të AK-së.

NJËSIA E PROKURIMIT